



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/105;
Datë: 23.09.2016 .

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-04-7543	1	27.09.2016

Në bazë të nenit 61 paragrafi 2 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr. 03/L-048); nenit 40 paragrafi 2 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika e) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 19 paragrafi 15 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 23.09.2016 nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2017

I. Me këtë vendim **miratohet** buxheti i Komunës së Junikut për vitin 2017 i propozuar nga kryetari i Komunës së Junikut.

II. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut për vitin 2017 është: **1.533.899,00 €**, dhe është i shpërndarë në linjat buxhetore si në vijim:

1. Paga dhe mëditje: 1.000.466,00 €,
2. Mallra dhe shërbime: 130.012,00 €,
3. Shpenzime komunale: 30.000,00 €,
4. Subvencione dhe transfere: 5.755,00 €,
5. Investime kapitale: 367.666,00 €.

III. Për zbatimin e këtij vendimi respektivisht ekzekutimin e buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2017 sipas linjave buxhetore nga pika II. e këtij vendimi është përgjegjës kryetari i Komunës së Junikut.

IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

VI. Vendimi iu dërgohet:

1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
2. Ministrisë së Financave,
3. Kryetarit të Komunës së Junikut,
4. Shërbimit të Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
5. Arkivit të Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://rks-gov.net/junik>